



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

*Dokument Parlamentar
Tiranë, më 06.03.2019*

**RAPORT
PËR
PROJEKTLIGJIN
“PËR NXITJEN E PUNËSIMIT”**

- Hyrje

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjen e datave 25.02.2019 dhe 06.03.2019, mori në shqyrtim projektligjin “Për nxitjen e punësimit”.

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut caktoi relatore për shqyrtimin e këtij projektligji deputeten Elena Xhina.

Në mbledhjet e Komisionit për të mbrojtur projektligjin dhe për të dhënë shpjegime për pyetjet e anëtarëve të Komisionit ishin të pranishëm znj. Dajna Sorensen zëvendësministre e e Financave dhe Ekonomisë dhe përfaqësues të kësaj ministrie.

I. BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 78, 83, pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

II. QËLLIMI DHE RISITË E PROJEKTLIGJIT

2.1. Qëllimi i projektligjit

Projektligji i ri “Për nxitjen e punësimit”, ka si qëllim identifikimin dhe skicimin e politikave të duhura nxitëse të punësimit në vend dhe kualifikimit profesional të forcës së punës, me qëllim që të hapen vende pune cilësore dhe mundësi për aftësi gjatë gjithë ciklit të jetës. Projektligji ka në qendër të tij rritjen e mundësive për punë të denjë nëpërmjet politikave efikase të tregut të punës, nxitjen e përfshirjes dhe kohezionit social, si dhe fuqizimin e tregut të punës. Disa aspekte të tregut të punës dhe të ofertës së aftësive kërkojnë ndryshime rrënjësore

dhe në të njëjtën kohë sistemi duhet të vazhdojë të hartojë politika të cilat janë domethënëse për situatën aktuale dhe, si të tilla, këto politika duhet të jenë realiste, të qenësishme dhe të arritshme në kohë duke u bazuar në kapacitetin për të ndryshuar dhe burimet ekzistuese.

Synimi kryesor i projektligjit është rritja e punësueshmërisë së fuqisë punëtore përmes ofrimit të shërbimeve publike dhe programeve të punësimit dhe vetëpunësimit, si dhe formimit profesional. Nëpërmjet kësaj nisme ligjore synohet arritja e objektivave të mëposhtme:

- Rritja e efikasitetit të fuqisë punëtore, duke ndihmuar që të papunët dhe personat ekonomikisht pasivë të punësohen.
- Ofrimi i shërbimeve të cilësisë së lartë dhe që udhëhiqen nga kërkesa, të cilat ndihmojnë në plotësimin e vendeve të lira të punës në mënyrë të shpejtë dhe efikase.
- Rritja e mundësive të punësimit të personave me aftësi të kufizuara.
- Përmirësimi i kapaciteteve të Shërbimit Kombëtar të Punësimit në mënyrë që ai të kryejë të gjitha funksionet e një shërbimi modern të punësimit në të gjithë vendin.

2.2 Risetë e këtij projektligji janë:

- a. Ky projektligj bën rregullimin e bazës ligjore për modelin e ri të shërbimeve të punësimit, ku përfshihen:
 - i. informimi i punëkërkuesve dhe punëdhënësve;
 - ii. ndërmjetësimi për punësim, si një mjet që synon gjetjen e një vendi të përshtatshëm pune një punëkërkuesi, formimi, aftësitë dhe cilësitë e të cilit përputhen me kërkesat e deklaruara nga punëdhënësi për këtë vend pune;
 - iii. këshillimi dhe orientimi për karrierë që ka për qëllim t'i ndihmojë punëkërkuesit në zgjedhjen dhe formimin e tyre në një profesion të përshtatshëm me cilësitë individuale dhe të kërkuar në tregun e punës.
- b. Rishikimi i termonologjisë si rezultat i rekomandimeve të Bashkimit Evropian dhe standardeve ndërkombëtare ILO Cedefop.
- c. Nxitja e punësimit të personave me aftësi të kufizuara, duke rregulluar atë pjesë të ligjit ekzistues i cili ishte i pazbatueshëm në praktikë për shkak të mos krijimit të fondit kombëtar të punësimit ku do të derdheshin detyrimet e punëdhënësve. Përveç mbështetjes për programe nxitjeje punësimi, përshtatjeje të arsyeshme, janë rregulluar dhe çështjet e detyrimit për të punësuar persona me aftësi të kufizuara nga punëdhënësit.
- d. Rikonceptimi i marrëdhënies me punëdhënësit, duke e konsideruar atë si një proces bashkëpunimi dhe jo një proces detyrimesh të njëanshme nga ana e punëdhënësve.
- e. Parashikimi i detyrimit të punëdhënësve përfitues të fondeve publike, për të punësuar punëkërkues të papunë të regjistruar në strukturat rajonale/vendore të punësimit, sipas rregullave që do të vendosen nga Këshilli i Ministrave.
- f. Parashikimi i ngritjes së Fondit Social të Punësimit, i cili do të përdoret nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive për zbatimin programeve që synojnë punësimin, vetëpunësimin, aftësimin dhe riaftësimin profesional si dhe përshtatje të vendit të punës të personave me aftësi të kufizuara për nxitjen e punësimit të kësaj kategorie vulnerabël.
- g. Ngritja e Agjencisë Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (AKPA), e cila do të zëvendësojë Shërbimin Kombëtar të Punësimit pa ndryshuar statusin e tij ligjor.

2.3 Impakti ekonomik dhe social

2.3.1 Impakti ekonomik:

- kosto të drejtpërdrejta për sektorin publik të lidhura me financimin nga buxheti i shtetit të krijimit të Agjencinë e re Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, funksionimin e Agjencisë, ofrimin e shërbimeve prej saj dhe kryerjen e funksioneve administrative nga ana e Agjencisë.
- kosto të drejtpërdrejta për bizneset si rezultat i kërkesës për të punësuar një person me aftësi të kufizuara për çdo 50 punonjës.
- kompanitë që plotësojnë vendet e lira të punës falë aktiviteteve të programit do të jenë në gjendje të rrisin prodhimin e tyre si rezultat i rritjes së ofertës së fuqisë punëtore.
- Përfitimi kryesor i drejtpërdrejtë ekonomik që pritet të vijë si rezultat i kësaj nisme do të jetë ai që individët do të marrin në formën e pagave si përfitues të programit teksa ata janë të punësuar.

2.3.2 Impakti social:

- barazi më të madhe në tregun e punës;
- njohuri të përmirësuara në lidhje me tregun e punës në Shqipëri dhe përmirësim të koordinimit dhe menaxhim efikas të shërbimeve publike;
- përmirësime të mirëqenies personale të fituara nëpërmjet punësimit dhe ndikime pozitive në komunitetin e gjerë nëpërmjet rritjes së punësimit.

III. PARASHIKIMET KUSHTETUESE DHE AKTET NDËRKOMBËTARE NË FUSHËN E NXITJES SË PUNËSIMIT

3.1 Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

Neni 59 i Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë që parashikon objektivat sociale të shtetit, përcakton se:

“Shteti brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon si dhe në plotësim të nismës dhe të përgjegjësisë private synon punësimin në kushte të përshtatshme të të gjithë personave të aftë për punë”.

Objektivat Sociale ndryshojnë nga të drejtat dhe liritë themelore, sepse nuk konsiderohen si një e drejtë dhe të mund të atakohen në gjykatë. **Ato janë një detyrim, i cili mbetet mundësi reale e shtetit, pavarësisht standarteve të përcaktuara në Kushtetutë dhe në akte të tjera ligjore e nënligjore.** Në kuadrin e përpjekjeve për ndërtimin e shtetit social, është e drejtë legjitime e vetë shtetit të rregullojë sistemin e mbrojtjes sociale, duke hartuar dhe zbatuar politikat dhe strategjitë sociale.

Në këtë kuptim, ligjvënësi duhet të çmojë vetë, sipas përparësive që ai ka vendosur për zhvillimin ekonomik e shoqëror, se cilat janë format më të përshtatshme për balancimin e interesave duke bërë edhe diferencimet e arsyeshme, pa cenuar parimet dhe normat kushtetuese. Në çdo rast, këto rregullime duhet të përputhen me parimet, vlerat dhe standardet kushtetuese dhe me detyrimet që burojnë nga Karta Sociale Evropiane, që janë barazia, drejtësia sociale, respekti për të drejtat e njeriut dhe ndalimi i diskriminimit.

Shteti, me qëllim garantimin e dinjitetit njerëzor, të një niveli të pranueshëm jetese, si dhe ruajtjen e interesave të të gjitha shtresave të shoqërisë, mund të ndryshojë mekanizmin e

realizimit të këtyre të drejtave, veçanërisht kur nuk ka mundësi financiare për rishpërndarje proporcionale të fondeve në dispozicion, ose kur këto masa diktohen nga nevoja për të eliminuar apo parandaluar rreziqe reale ndaj sigurisë ekonomike¹.

3.2 E drejta për punësim është sanksionuar në disa konventa dhe instrumente ndërkombëtare të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë këtu mund të përmendim:

- Kartën Sociale Evropiane e ratifikuar me ligjin nr. 8960, datë 24.10.2002. Në nenin 1 të së cilës afirmohet se:
Me synimin që të sigurohet ushtrimi efektiv i së drejtës për punë, Palët angazhohen:
 - *Të pranojnë si një nga synimet dhe përgjegjësitë e tyre parësore arritjen dhe mbajtjen e një niveli sa më të lartë e të qëndrueshëm të mundshëm punësimi, me synim që të arrihet punësim i plotë;*
 - *Të mbrojnë efektivisht të drejtën e punëtorit për të fituar jetesën e tij në një punë në të cilën ka hyrë lirisht;*
 - *Të krijojnë dhe mbajnë shërbime punësimi falas për të gjithë punëtorët;*
 - *Të japin dhe të nxisin orientim, trajnim dhe rehabilitim profesional të përshtatshëm.*
- Konventa nr.168 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës "Për nxitjen e punësimit dhe mbrojtjen nga papunësia", 1988, e ratifikuar me ligjin nr. 9547, datë 01.06.2006 në nenet 2 dhe 7 së saj përcaktohet që:

“Çdo anëtar do të marrë hapat e duhur për të koordinuar sistemet e mbrojtjes kundër papunësisë dhe politikës së punësimit. Për këtë qëllim, do të kërkojë të sigurojë që sistemi i tij i mbrojtjes kundër papunësisë, dhe veçanërisht metodat që ofrojnë përfitim nga papunësia, kontribuojnë në nxitjen e punësisë së plotë produktive dhe të zgjedhur lirshëm, dhe që nuk frenojnë punësuesit të ofrojnë dhe punëtorët të kërkojnë punësim produktiv.

Çdo anëtar do të deklarojë si një përparësi objektive një politikë që synon të nxisë punësim të plotë produktiv e të zgjedhur lirshëm me të gjitha mënyrat duke përfshirë sigurimet shoqërore. Këto mënyra duhet të përfshijnë inter alia (ndërmjet të tjerash) shërbime punësimi, trajnime profesionale dhe orientime profesionale.

Nisma ligjore përmbush një prej Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm të Agjendës 2030 të Shteteve anëtare të Kombeve të Bashkuara të adoptuara nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara përkatësisht:

Objektivi 8: *Promovimi i rritjes ekonomike të qëndrueshme, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme, punësimit të plotë dhe produktiv dhe punës së denjë për të gjithë.*

IV. ÇËSHTJET E DISKUTUARA NË KOMISION

Gjatë shqyrtimit të këtij projektligji nga relatorja dhe anëtarët e komisioni u theksua rëndësia e miratimit të këtij projektligji, i cili synon rritjen e mundësive për punësim nëpërmjet politikave efikase të tregut të punës, nxitjen e përfshirjes dhe kohezionit social, si dhe fuqizimin

Vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.1, datë 06.02.2013 dhe nr. 34, datë 28.05.2012

e tregut të punës. Disa nga çështjet që morën vëmendje të veçantë gjatë shqyrtimit nen për nen të projektligjit janë të lidhura me:

1. Saktësimin në dispozitat e projektligjit të statusit juridik dhe kompetencave të institucionit përgjegjës për punësimin dhe aftësitë

Anëtarët e Komisionit për Çështjet Ligjore Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut diskutuan në lidhje me domosdoshmërinë e parashikimit në dispozitat e projektligjit, të statusit juridik, mënyrës së organizimit dhe kompetencave kryesore, që do të ketë institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësinë. Pas diskutimit edhe me përfaqësues të Departamentit të Administratës Publike duke marrë në konsideratë edhe parashikimet e ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” sipas të cilit: “përvec kur parashikohen drejtëpërdrejtë nga ligji, institucioni e varësisë krijohen dhe mbyllen nga Këshilli i Ministrave...”, Komisioni vlerësoi që çështjet kryesore të lidhura me:

- statusin e institucionit përgjegjës si person juridik publik në varësi të ministrit për çështjet e punësimit dhe zhvillimit të aftësive;
- mënyrën e organizimit territorial;
- kompetencat kryesore të këtij institucioni.

të jenë të trajtuara dhe të parashikuara në projektligj. Ndërkohë që vendimi i Këshillit të Ministrave mund të përcaktojë rregulla më të detajuara lidhur me mënyrën e organizimit dhe funksionimit të tij referuar standardeve të përcaktuara në ligjin nr. 90/2012.

2. Shmangia e mbivendosjeve me parashikimet e Kodit të Punës

Gjatë shqyrtimit të këtij projektligji anëtarët e komisionit diskutuan lidhur me nevojën për shmangien e mbivendosjeve dhe paqartësive, që mund të krijohen nga dispozitat që propozojnë krijimin e Këshillit Konsultativ Tripalësh dhe Këshillit Vendor Tripalësh, në raport me dispozitat e Kodit të Punës, të cilat trajtojnë Këshillin Kombëtar të Punës dhe Këshillin Konsultativ Tripalësh Rajonal.

Përfaqësuesit e ministrisë përgjegjëse për çështjet e nxitjes së punësimit, sqaruan se Këshilli Konsultativ Tripalësh i parashikuar në këtë projektligj nuk krijon mbivendosje me dy Këshillat e parashikuar përkatësisht në nenet 200 dhe 200/1 të Kodit të Punës. Kjo pasi Këshilli Konsultativ Tripalësh sipas parashikimeve të këtij projektligji do të ngrihet si organ Këshillimor pranë Agjencisë për Punësimin dhe Aftësinë dhe do të ketë si fushë të veprimtarisë së tij konsultimin për programe të lidhura me nxitjen e punësimit për punëkërkuesit e papunë. Ndërkohë që Këshilli Kombëtar i Punës ka si qëllim shqyrtimin e çështjeve me interes të përbashkët për organizatat e punëdhënësve dhe sindikale, të lidhura me veçanërisht me zbatimin e legjislacionit të punës, kushtet e punës, programet e zhvillimit ekonomik e social etj. Sipas përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për nxitjen e punësimit, ngritja e këtij organi këshillimor përmbush një nga kërkesat e Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO).

Në këtë kuadër, me qëllim saktësimin dhe shmangien e çdo paqartësie lidhur me qëllimin e ngritjes së Këshillit Konsultativ dhe kompetencat që ai do të gëzojë u propozua riformulimi i dispozitave që parashikojnë ngritjen e Këshillit Konsultativ Tripalësh dhe heqja e nenit që përcakton Këshillin Vendor Tripalësh.

3. Nxitja e punësimit të personave me aftësi të kufizuar

Gjatë shqyrtimit të projektligjit në komision, diskutimi u fokusua edhe në masat e propozuara për nxitjen e punësimit të personave me aftësi të kufizuara, ku është parashikuar detyrimi i institucioneve publike dhe personave juridik privat për punësimin e një person me aftësi të kufizuar për çdo 50 punonjës. Anëtarët e komisionit kërkuan shpjegime lidhur me raportin e propozuar dhe efektet që pritet të ketë ky parashikim në nxitjen e punësimit të kësaj kategorie vulnerabël. Përfaqësuesit e ministrisë përgjegjëse për çështjet e punësimit sqaruan se caktimi i kuotave për punësimin e personave me aftësi të kufizuara, është bërë duke marrë në konsideratë zhvillimet e ndodhura në lidhje me madhësinë, tipologjinë e bizneseve në sektorin privat në krahasim me parashikimet e përpara 23 viteve. Detyrimi për vendosjen e kuotave për punësimin e personave me aftësi të kufizuara është një praktikë që përdoret nga shumë shtete si një mënyrë për përfshirjen e kësaj kategorie në tregun e punës. Njëkohësisht u evidetua se dispozitat e ligjit aktual në lidhje me personat me aftësi të kufizuara nuk kanë qenë aspak të zbatueshme për shkak të mos krijimit të fondit kombëtar të punësimit, ku do të derdreshin detyrimet e punëdhënësve, në rastin e moszbatimit të këtij detyrimi ligjor.

Nëpërmjet propozimeve të këtij projektligji parashikon që të ardhurat e mbledhura nga kontributi i punëdhënësve që nuk punësojnë persona me aftësi të kufizuara të vihen në dispozicion të Fondit Social të Punësimit, i cili do të përdoret edhe për zbatimin e programeve të nxitjes së punësimit për personat me aftësi të kufizuara në bashkëpunim me punëdhënësit.

Njëkohësisht vendosja e detyrimit për punësimin e personave me aftësi të kufizuara është në harmoni me angazhimet e marra përsipër nga vendi ynë si rezultat i ratifikimit të Konventës së OKB “Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara”. Neni 27 i kësaj Konvente detyron shtetet palë që:

Të njohin të drejtën e personave me aftësi të kufizuara për të punuar, në baza të barabarta me të tjerët; kjo përfshin të drejtën për të pasur mundësinë për të fituar jetesën, duke bërë punë të zgjedhur lirisht apo të pranuar në tregun e punës dhe ambientin e punës që është i hapur, përfshirës dhe i arritshëm nga personat me aftësi të kufizuara. Shtetet palë duhet të mbrojnë dhe promovojnë realizimin e së drejtës për punë, përfshirë dhe ata që e fitojnë aftësinë e kufizuar gjatë punësimit, duke marrë hapat e duhur, përfshirë nëpërmjet legjislacionit, ndër të tjera:

- *Për të punësuar personat me aftësi të kufizuara në sektorin publik;*
- *Për të promovuar punësimin e personave me aftësi të kufizuara në sektorin privat nëpërmjet politikave dhe masave të duhura, të cilat mund të përfshijnë programe veprimi afirmative, nxitëse dhe masa të tjera;*
- *Për të promovuar programe për rehabilitim profesional, mbajtjen e vendit të punës dhe kthimit në punë për personat me aftësi të kufizuara.*

V. REKOMANDIME PËR KOMISIONIN PËRGJEGJËS

- Në lidhje me nenin 5 pika 3 i rekomandohet komisionit përgjegjës, që të parashikojë se zbatimi i politikave do të kryehet nga institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë në bashkëpunim me punëdhënësit.
- Në nenin 7 i rekomandohet komisionit përgjegjës që pas pikës 6 të shtohet një paragraf sipas të cilit kriteret, që duhet të plotësojnë subjektet private për ofrimin e ndërmjetësimit dhe këshillimit profesional të përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
- Duke marrë shkas nga diskutimet e bëra nga anëtarët e komisionit lidhur me kuotat e punësimit të personave me aftësi të kufizuara dhe penalitetet e propozuara në rastin e moszbatimit të këtij detyrimi, i sugjerohet komisionit përgjegjës që të vlerësojë parashikimet e pikave 1 dhe 2 të nenit 21 me qëllim sigurimin e një balance të duhur

proporcionale ndërmjet detyrimit që parashikohet të vendoset ndaj punëdhënësve me qëllimin që kërkohet të arritet, i cili lidhet me nxitjen efektive të punësimit të personave me aftësi të kufizuara, në konsideratë edhe të komenteve të paraqitura nga Avokati i Popullit dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Me qëllim që të sigurohet zbatimi në praktikë i detyrimit të punëdhënësve për të siguruar ruajtjen e vendit të punës për ata individë, të cilët, në kohën e punësimit nuk kanë qenë me aftësi të kufizuara, por e kanë fituar aftësinë e kufizuar nga aksidentet në punë ose nga sëmundjet profesionale, i sugjerohet komisionit përgjegjës që mosrespektimi i këtij detyrimi të konsiderohet kundërvajtje administrative duke parashikuar aplikimin e sanksioneve përkatëse referuar legjislacionit në fuqi për inspektimin e punës.

- Në dispozitat kalimtare i sugjerohet komisionit përgjegjës që të parashikojë çështje të lidhura me:
 - i. Afatin e ngritjes së institucionit përgjegjës për punësimin dhe aftësitë.
 - ii. Kalimin e të gjitha të drejtave, detyrimeve, buxhetin, si dhe dokumentacionin administrativ dhe financiar i të SHKP tek institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë.
- Lidhur me afatin e nxjerrjes së akteve nënligjore, i sugjerohet Komisionit përgjegjës shkurtimi i tyre, me qëllim që të të sigurohet zbatimi efektiv i parashikimeve të këtij projektligji në afate më të shpejta.

VI. RIFORMULIMET SIPAS NENEVE

Në përfundim, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, gjatë shqyrtimit nën për nën të këtij projektligji, pas rakordimit edhe me përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për çështjet e nxitjes së punësimit miratoi dhe i përcjell komisionit përgjegjës këto ndryshime:

Neni 1

Shprehja “me legjislacion specifik” të zëvendësohet me shprehjen “nga legjislacioni i posaçëm”.

Neni 3

- Në pikën 4 përpara shprehjes “legjislacionit në fuqi”, të shtohet shprehja “...Kodit të Punës dhe...” dhe fjalët “persona të tjerë” të zëvendësohen me fjalën “punëkërkues”.
- Pika 13 sugjerohet të riformulohet me këtë përmbajtje:
“Shërbime punësimi”, janë shërbimet, të cilat synojnë të informojnë, të këshillojnë, të orientojnë dhe të ndërmjetësojnë, punësimin sa më të shpejtë të punëkërkuesve dhe punëkërkuesve të papunë të regjistruar, nëpërmjet ndihmës së shënjestruar dhe të zhvillojnë konkurrueshmërinë në tregun e punës.
- Pika 14 në aspektin e teknikës legjislative të riformulohet si më poshtë:
“Aftësim dhe rehabilitim për punë për personat me aftësi të kufizuara”, janë shërbimet mbështetëse dhe asistencë për vlerësimin e aftësisë për punë të personit me aftësi të kufizuara të cilat ofrohen nëpërmjet:

- i. informimit, këshillimit profesional, vlerësimit të aftësive profesionale dhe gjetjes së punës;
- ii. vlerësimit të mundësisë për aftësim, dhe hartimit të programeve përkatëse;
- iii. aftësimit profesional, kualifikimit plotësues, rikualifikimit me programet e mbajtjes dhe përmirësimit të aftësive të punës deri në momentin e punësimit.
- Pika 15 të riformulohet me këtë përmbajtje:
15. *“Përshtatje e arsyeshme”, ka të njëjtin kuptim me atë që parashikohet në legjislacionin në fuqi për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara.*
- Në pikën 17 të bëhen këto ndryshime:
 - i. Shkronja “a” të riformulohet si vijon:
individët me statusin e jetimit që ndodhen në kushte të vështira ekonomike;
 - ii. Shkronja “dh” të riformulohet:
“persona që kanë vuajtur dënimin me burgim apo ndaj të cilëve është vendosur pezullimi i vendimit me burgim dhe zëvendësimin e tij me një dënim alternativ;”
 - iii. Në fund të shkronjës “g” të shtohet shprehja: *“sipas parashikimeve të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur”.*
 - iv. Shkronja “h” me qëllim që të sigurohet përputhshmëria me konventën e Këshillit të Evropës për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore të riformulohet:
“h. viktimat e trafikimit/viktimat e mundshme të trafikimit”.
 - v. Pas shkronjës “h” shtohen shkronjat “i” dhe “j”, me këtë përmbajtje:
*“i. viktimat e dhunës me bazë gjinore dhe viktimat e dhunës në familje;
j. Nënats nën moshën 18 vjeç.”*
- Pas pikës 17 të shtohet një pikë 18 ku të jepet përkufizimi i programeve aktive të tregut të punës në koherencë me standartet ndërkombëtare të ILO-s dhe Bankës Botërore si më poshtë:
“Programe aktive të tregut të punës” janë programe që synojnë të mbajnë të punësuarit në tregun e punës, të mbështesin punëkërkuesit e papunë të hyjnë në tregun e punës, të rrisin produktivitetin dhe të ardhurat nga puna dhe të përmirësojnë funksionimin e tregut të punës”.
Ky sugjerim të reflektohet edhe në pikën 1 të nenit 6 të projektligjit.
- Pas pikës 18 të shtohet pika 19 ku të jepet përkufizimi i forcës së punës duke patur parasysh rekomandimet e Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) si më poshtë:
“Forca e punës” përfshin personat e punësuar dhe të papunët”.

Neni 4

- Pikat 1 dhe 2 të bashkohen në një paragraf të vetëm me këtë përmbajtje:
“Çdo punëkërkues dhe punëdhënës i regjistruar në strukturën rajonale/vendore përfiton nga shërbimet që ofrohen nga kjo strukturë.”
- Në fund të pikës 3 të shtohet shprehja *“në përputhje me legjislacionin në fuqi për të huajt.”.*

Neni 5

- Pika 1 të hiqet dhe të shtohet si paragraf i veçantë në nenin 3 që parashikon përkufizimet e termave që përdoren në këtë projektligj.

- Fjalja hyrëse e pikës 2 të riformulohet me këtë përmbajtje:
“ministria, në lidhje me politikën e punësimit, ushtron këto kompetenca:
- Në pikën 2 shkronja “a” të riformulohet si vijon:
“analizon, periodikisht tendencat e tregut të punës dhe parashikon zhvillimet e tij”;
- Duke qënë se funksioni më i rëndësishëm i një ministrie është ai politik-bërës sugjerohet që në pikën 2 pas shkronjës “a” të shtohet shkronja “a/1 si më poshtë:
“harton politika të reja për rritjen e punësimit dhe uljen e papunësisë”.
- Në pikën 2 shkronja “ç” pas shprehjes “...në Republikën e Shqipërisë” shtohet togfjalëshi “...sipas legjislacionit në fuqi për të huajt..”.
- Në fund të pikës 3 të shtohet shprehja “që ngrihet sipas parashikimeve të këtij ligji dhe strukturave rajonale vendore në varësi të saj”.

Neni 7

- Në pikën 1 shkronja “a” togfjalëshi “...dhe personat e interesuar...” të zëvendësohet me togfjalëshin “...dhe për çdo person të interesuar...”.
- Në pikën 3 fjala “për ofrimin” të zëvendësohet me fjalët “për të siguruar” dhe fjala “fizike” të hiqet.

Neni 10

Në pikën 3 shkronjat “a”, “b” dhe “c” pas fjalës “nxënësit” sugjerohet të shtohet fjala “studentët” si grup më vetë dhe i lidhur drejtëpërsëdrejtë me nevojën për shërbimet për këshillim, orientim për karrierë, punësim e profesion.

Neni 11

- Në pikën 3 fjalja e dytë të riformulohet si vijon:
Institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë mund të kontraktojë subjekte të tjera publike, private apo organizata të shoqërisë civile, veprimtaria e të cilëve është e lidhur me fushën e punësimit, për të bërë të mundur zbatimin me cilësi dhe në kohë të programeve të nxitjes së punësimit”.

Neni 12

- Me qëllim harmonizimin e parashikimeve të këtij projektligji me ligjin 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional” sugjerohet që pika 1 të riformulohet me këtë përmbajtje:
“Formimi profesional u shërben si punëkërkuësve ashtu dhe punëdhënësve, dhe realizohet nëpërmjet kurseve të unifikuara të formimit profesional publik”.
- Pika 2 sugjerohet të hiqet.
- Me qëllim harmonizimin e parashikimeve brenda dispozitës, pika 4 të riformulohet me këtë përmbajtje:

“4. Punëkërkuessit e papunë, përfitojnë kurse pa pagesë të formimit profesional, të ofruara nga institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë. Punëkërkuessit e papunë, në raste të vecanta mund të përfitojnë një pagesë për pjesëmarrje në kurs. Këshilli i Ministrave përcakton me vendim rastet e përftimit dhe masën e pagesës për pjesëmarrje në kurs.”

Neni 13, me qëllim përshtatjen e titullit të dispozitës me përmbajtjen e saj referuar edhe parashikimeve të ligjit nr. 7703/1993 “Për sigurimet shoqërore”, i ndryshuar sugjerohet që neni 13 të riformulohet me këtë përmbajtje:

“Punëkërkuessit e papunë, të cilët plotësojnë kushtet për përftimin e të ardhurave nga papunësia dhe regjistrohen në strukturën rajonale/vendore si punëkërkuess të papunë në zbatim të legjislacionit për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë, përfitojnë nga pagesa e të ardhurave nga papunësia.”

Neni 14 sugjerohet të riformulohet me këtë përmbajtje:

*“Neni 14
Institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë*

1. Institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë është person juridik publik në varësi të ministrisë përgjegjëse për çështjet e punësimit dhe zhvillimit të aftësive, i organizuar në nivel qendror dhe rajonal/vendor.

2. Institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë ushtron kompetencat e mëposhtme:

- a. administron strukturat rajonale e vendore të punësimit dhe garanton nivelin e cilësisë së shërbimeve të ofruara;*
- b. në bashkëpunim me punëdhënësit, administron dhe zbaton programet e nxitjes së punësimit;*
- c. administron ofruesit publikë të arsimit dhe formimit profesional (AFP), sipas legjislacionit në fuqi për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”.*
- d. zbaton programet e formimit profesional;*
- e. i propozon ministrisë përgjegjëse për çështjet e punësimit dhe zhvillimit të aftësive, aktet ligjore dhe nënligjore në fushën e nxitjes së punësimit.*
- f. ushtron kompetenca të parashikuara nga ky ligj dhe nga ligje të tjera.*

3. Rregulla të hollësishme për organizimin dhe funksionimin e institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 15 sugjerohet të ndryshohet me këtë përmbajtje:

*“Neni 15
Këshilli Konsultativ për Punësimin*

1. *Këshilli Konsultativ për Punësimin është organ këshillimor që ngrihet pranë institucionit përgjegjës për punësimin dhe aftësitë, me përfaqësimin e organizatave të punëdhënësve, organizatave sindikale si dhe institucioneve shtetërore.*
2. *Këshilli kryesohet nga ministri dhe përbëhet nga 11 anëtarë si më poshtë:*
 - a. *1 përfaqësues nga ministria përgjegjëse për financat;*
 - b. *1 përfaqësues nga ministria përgjegjëse për çështjet sociale;*
 - c. *1 përfaqësues nga ministria përgjegjëse për arsimin;*
 - d. *1 përfaqësues nga inspektorati shtetëror që mbulon fushën e punës;*
 - e. *1 përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;*
 - f. *1 përfaqësues nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore;*
 - g. *2 përfaqësues nga organizatat më të përfaqësuara sindikale;*
 - h. *2 përfaqësues nga organizatat më të përfaqësuara të punëdhënësve.*
3. *Anëtarët e Këshillit emërohen me urdhër të ministrit, pas propozimit nga institucionet/organizatat e parashikuara në pikën 2 të këtij neni, për një mandat 3 vjeçar.*
4. *Përzgjedhja e organizatave më të përfaqësuara sindikale dhe të punëdhënësve bëhet nga ministri sipas vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave për caktimin e organizatave më të përfaqësuara sindikale dhe të punëdhënësve.*
5. *Këshilli Konsultativ për Punësimin ushtron kompetencat e mëposhtme:*
 - a) *Diskuton çështjet që lidhen me shërbimet e punësimit dhe programet e nxitjes së punësimit.*
 - b) *Nxit bashkëpunimin efektiv ndërmjet organizatave të punëdhënësve dhe organizatave sindikale për çështjet e nxitjes së punësimit;*
 - c) *Këshillon lidhur me mënyrën e përdorimit të Fondit Social të Punësimit sipas parashikimeve të këtij ligji.*
6. *Rregulla më të detajuara për organizimin, funksionimin dhe kompetencat e Këshillit Konsultativ për Punësimin përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.*

Neni 16 sugjerohet të hiqet.

Neni 17

- Pika 1 të riformulohet me këtë përmbajtje:
“1. Institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë mbledh, përpunon dhe analizon informacion nëpërmjet sistemit të informacionit të institucioneve të varësisë ose nëpërmjet studimeve specifike apo anketimeve, që kanë të bëjnë me dinamikën dhe tendencat e tregut të punës apo të segmenteve të tij. Institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë raporton në ministri dhe në institucione të tjera publike e private, që e kërkojnë një informacion të tillë.”

Neni 18

- Titulli i nenit 18 të ndryshohet: *« Mbledhja, shpërndarja e të dhënave dhe bashkëpunimi me institucione të tjera ».*

- Në pikat 1 dhe 2 fjala « INSTAT » të zëvendësohet me « institucioni përgjegjës për statistikat zyrtare ».
- Pika 3 sugjerohet të riformulohet si më poshtë :
« Cdo institucion i administratës publike ka detyrimin e dhënies së informacionit, të kërkuar nga institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë, për qëllimet e zbatimit të këtij ligji, në përputhje me rregullat dhe afatet e parashikuara nga legjislacioni në fuqi si dhe ka të drejtën që të kërkojnë e të marrin informacion prej saj. »
- Pas pikës 3 sugjerohet të shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:
« Ruajtja dhe përpunimi i informacionit, që shkëmbehet sipas parashikimeve të pikës 3 të këtij neni, bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. »

Neni 20

- Pika 1 sugjerohet të riformulohet me këtë përmbajtje:
“1.Në rastet e fillimit të procedurave të falimentit me kërkesë të punëdhënësit, sipas legjislacionit në fuqi për falimentin, ky i fundit njofton strukturën përkatëse rajonale/vendore, jo më vonë se 20 ditë kalendarike për vendimin e gjykatës për fillimin e procedurave të falimentit.”
- Pika 3 të riformulohet:
“3. Rregullat dhe procedurat për zbatimin e pikës 2 të këtij neni përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave”.

Neni 21

- Pika 3 sugjerohet të riformulohet me këtë përmbajtje:
“3. Punëdhënësit, marrin masat e nevojshme për plotësimin e vendeve të lira të punës me persona me aftësi të kufizuara. Në rastin kur punëdhënësi nuk mund të identifikojë persona me aftësi të kufizuar, për zbatimin e detyrimit sipas pikës 1 të këtij neni, paraqet kërkesë pranë strukturës përkatëse rajonale/vendore, e cila vë në dispozicion listën e punëkërkuësve të papunë të regjistruar për këtë kategori. Për qëllime të zbatimit të kësaj pike, struktura rajonale/vendore, ndërmjetëson lidhur me përputhjen e vendit të punës me mundësitë e personave me aftësi të kufizuara.”
- Pika 4 sugjerohet të riformulohet me këtë përmbajtje:
“Punëdhënësit, publikë dhe privatë, mund të punësojnë në një njësi prodhimi, një numër më të madh punonjësish me aftësi të kufizuara se ajo e parashikuar sipas pikës 1 të këtij neni. Institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësinë mund të lejojë kompensimin e tepërcave të numrit më të vogël të punonjësve të punësuar në njësi tjetër të këtij subjekti, në të njëjtin rajon apo në rajone të tjera.”
- Pika 5 sugjerohet që të hiqet, pasi ligji nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuar”, nuk bën një ndarje të shkallës së aftësisë së kufizuar.

Neni 22

Në fund të pikës 4, të shtohet një fjali me këtë përmbajtje:

“Të ardhurat e Fondit Social të Punësimit sipas pikës 2 të këtij neni nuk mund të përdoren për qëllime të tjera, përveç atyre të parashikuara në këtë pikë.”

Neni 23

Ky nen riformulohet me këtë përmbajtje:

“Neni 23

Sanksionet

- 1. Shkelja e parashikimeve të pikës 2, të nenit 21, të këtij ligji, konsiderohet kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga inspektoratit shtetëror që mbulon fushën e punës sipas përcaktime të bëra nga legjislacioni në fuqi për inspektimin e punës.*
- 2. Procedurat e shqyrtimit dhe ankimit të bëhen në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për inspektimin e punës.*

Neni 24

Në këndvështrim të teknikës legjislative sugjerohet që neni 24 të kalojë pas nenit 25 dhe e anasjellta.

TË PËRGJITHSHME

1. Termat e përkufizuar në nenin 3 të projektligjit dhe ato që propozohet të shtohen, në këndvështrim të rregullave të teknikës legjislative të renditen sipas rendit alfabetik.
2. Rishikimi në tërësi i referencave ligjore të bëra në nene specifike të projektligjit për shkak të ndryshimeve që mund të vijnë nga rinumërimi i dispozitave ligjore.
3. Rinumërimi i neneve të projektligjit bazuar në sugjerimet për heqje të një dispozite ligjore.
4. Në dispozitën e nxjerrjes së akteve nënligjore të evidentohen saktësisht duke marrë në konsideratë ndryshimet e mundshme të referencave dhe propozimet e bëra, të gjitha dispozitat ligjore që delegojnë miratimin e akteve nënligjore nga Këshilli i Ministrave dhe ministri përgjegjës për çështjet e punësimit.

VII. PËRFUNDIM

Në përfundim, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, konstatoi se:

- Në aspektin ligjor, projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;
- Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit;

dhe pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, me votat e të gjithë anëtarëve të pranishëm e miratoi atë dhe u shpreh dakord për kalimin për votim në seancë plenare.

RELATORE

ELENA XHINA

KRYETAR

ULSI MANJA